



FAKULTETI KOMUNIKIM MASIV DHE GAZETARI

Master

REALIZIMI I TË DREJTËS PËR QASJE NË DOKUMENTE
PUBLIKE NGA MEDIUMET NË KOSOVË (2010-2020)

Mentori:
Prof. Ass. Dr. Resul Sinani

Kandidatja:
Jehona Fetaj

Prishinë, 2021

PËRMBAJTJA

Abstrakti.....	
Falenderimi.....	
HYRJE	
Qëllimi	
Objektivat	
Pyetjet Kërkimore	
Hipotezat	
Rëndësia e Temës	
Metodologjia	

KAPITULLI I

1.FILLET E LIRISË SË INFORMIMIT

1.1 Fillet e Lirisë së Informimit në Kosovë.....	
1.2 Agjencia për Informim dhe Privatësi	
1.3 Institucioni i Avokatit të Popullit	
1.5 Autoritetet Regjionale që Garantojnë Lirinë e Informimit	
1. 5.1 Komisioneri për të Drejtën e Informimit në Shqipëri	
1. 5.2 Komisioneri për Informacionet e Interesit Publik në Serbi	
1. 5.3 Autoriteti i Lirisë së Informimit në Maqedoninë e Veriut	
1. 5.4Agjencia për Qasje në Dokumente Publike në Malin e Zi	

KAPITULLI II

2. BETEJA E MEDIUMEVE PËR LIRINË E INFORMIMIT

2.1 E drejtës e qasje në dokumente publike	
2.2 Analiza raportëve gjithëpërfshirëse nga Zyra e Kryeministrit - (2010-2020).....	

2.3 Profili i aplikuesve për qasje në dokumente publike (2010-2020).....

KAPITULLI III

3.RASTI I STUDIMIT - REALIZIMI I TË DREJTËS PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE PËRMES GAZETARËV

3.1 Realizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike në Kosovë përmes gazetarëve.....

3.2 Vlerësimi kornizës ligjore për qasje në dokumente publike, sipas gazetarëve.....

3.3 Transparenca e Institucioneve.....

3.4 Procesi i ankimit në raste të heshtjes së refuzimit- Vështirësitë dhe pengesat.....

3.5 Specifikat e kërkesave për qasje në dokumente publike.....

KAPITULLI IV

4.1 Përfundime dhe Rekomandime

4.3 Bibliografia.....

4.4 Aneksë.....

ABSTRAKTI

Fillet e jetësimit në praktikë të së drejtës për t'u qasur në dokumentet publike në Kosovë datojnë katërmëdhjetë vite më parë, kur u miratuar ligji i parë për qasje në dokumente publike¹.

Komuniteti i gazetarisë, lirinë e informimit apo të drejtën për qasje në dokumente publike, deri para dy vitesh e ka jetësuar me vështirësi në raport me institucionet publike. Kjo, për faktin që zbatimi i këtij ligji është monitoruar nga një zyrë koordinuese pa mekanizëm konkret detyrues ndaj institucioneve publike, gjersa Institucioni i Avokatit të Popullit ka shërbyer si instancë e dytë, gjithashtu pa pasur mandat ekzekutiv për ta fuqizuar jetësimin e kësaj të drejte.

Përmbajtja e këtij shkrimi akademik, e cila, brenda trungut të vet, mes tjerash, sjell edhe autoritetet nga regjioni që janë të mandatuara për t'a garantuar lirinë e informimit në shtetet përkatëse, mundëson krahasimin e realizueshmërisë së kësaj të drejte në përgjithësi, e veçanërisht nga përfaqësuesit e medimeve.

Përkundër vështirësive për t'u qasur lirshëm në dokumentet publike, të cilat ligji i ka paraparë të jenë të hapura për publikun, si dhe besimit të humbur ndaj institucioneve publike në këtë drejtim, që nga viti 2019, kur mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike iu dha Agjencisë për Informim dhe Privatësi, përceptimi i përgjithshëm ka filluar të ndryshojë pozitivisht. Situata aktuale, për sa i përket respektimit të lirisë së informimit, mund të konsiderohet relativisht e kënaqshme, sepse institucionet publike janë të vetëdijshme për ekzistimin e autoritetit mbikëqyrës, i cili funksionon si autoritet i apelimit për qytetarët.

Fjalët kyce: Qasje, informim, autoritet, jetësim, garantim, mbikëqyrje.

¹ Gazeta Zyrtare e IPVK, Viti II, Nr.17, 1 tetor 2007

HYRJE

Garantimi i të drejtës për qasje në dokumente publike në vendin tonë bëhet në respektim të nenit 41 të Kushtetutës të Kosovës, i cili në pikën 1 garanton që: secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike,² si dhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike³.

Këto akte ligjore e fuqizojnë lirinë e informimit për çdo qytetar, pa dallim, edhe pse praktika e deritanishme ka dëshmuar se kjo e drejtë shfrytëzohet më racionalisht dhe më shpesh nga komuniteti i gazetarisë, respektivisht nga mediumet. Për të dëshmuar përkushtimin e vet serioz në realizimin e kësaj të drejte, shteti ka themeluar autoritetin e posaçëm mbikëqyrës, me status të pavarur veprimi, i cili, në kuadër të mandatit ligjor, mbikëqyrë institucionet publike, trajnon zyrtarët përgjegjës për qasje në dokumente publike dhe ndëshkon institucionet publike, në zbatim të ligjit përkatës.

Fakti që kjo e drejtë ka filluar së zbatuari që nga viti 2007 dhe se në shërbim të zbatimit të së njëjtës është ngritur një rrjet i tërë zyrtarësh përgjegjës për qasje në dokumente publike në çdo institucion publik, dëshmon se kjo e drejtë është duke u zbatuar relativisht kënaqshëm. Pavarësisht se optimumi i nivelit të dëshiruar të zbatueshmërisë kërkon përkushtim edhe më të madh dhe detyrim ligjor më efektiv në saje të mbikëqyrjes së institucioneve publike nga autoriteti përkatës, Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Lidhur me rëndësinë që ka zbatimi në praktikë i kësaj të drejte, janë hartuar shkrime akademike, kryesisht nga projekte të lancuara *ad hoc* nga organizata joqeveritare, përfshirë këtu edhe ato ndërkombëtare, qëllimi i të cilëve ka qenë paqsyrimi i gjendjes reale të zbatimit të ligjit përkatës që mbronë dhe fuqizon të drejtën për qasje në dokumente publike. Sidoqoftë, literatura në gjuhën shqipe rreth lirisë së informimit, siç quhet botërisht në mënyrë më të përgjithësuar kjo e drejtë, vazhdon të jetë e munguar për studjuesit e kësaj fushe që nuk zotërojnë anglishten apo gjuhë tjera të huaja.

Për të ofruar një pasqyrë sa më reale të zbatimit të kësaj të drejte në vendin tonë, duke e mbajtur në përqendrim të përhershëm komunitetin e gazetarisë, si realizues të së drejtës për t'u qasur në dokumentet që prodhohen, mbahen, ruhen, përpunohen nga institucionet publike, brenda

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41, pika 1, Prishtinë 2008, fq 13.

³ Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, korrik 2019

strukturës së këtij shkrimi akademik, do të paraqitet edhe një historik i hapave të parë të hedhur nga shteti drejt promovimit të kësaj monedhe të demokracisë, pra afirmimit të lirisë së informimit.

Theks i veçantë do t'i kushtohet rasteve specifike të adresuara nga përfaqësues mediumesh, sidomos gjatë dyvjeçarit të fundit, duke elaboruar spektrin e ngushtë të kërkesave për qasje të parashtruara nga gazetarët ndaj institucioneve publike.

Pasqyrat tabelare e statistikore do të paraqiten brenda trungut të këtij punimi për të dëshmuar përqindjen e kërkesave të aprovuara plotësisht, të atyre të aprovuara vetëm pjesërisht, pastaj të kategorisë së kërkesave ndaj të cilave institucionet publike kanë heshtur dhe të atyre që janë refuzuar.

Rastet studimore të ilustruara brenda kapitujve të këtij shkrimi do të analizojnë arsyetimet e paraqitura nga institucionet publike në rastet e refuzimeve, duke kundërgargumentuar arsyeshmërinë e paraqitur në mohim të kësaj të drejte themelore.

Rëndësi e veçantë brenda këtij punimi do t'i kushtohet punës praktike të Agjencisë për Informim dhe Privatësi sepse nga puna e saj e karakterit mbikëqyrës varet suksesi i pritur i jetësimit të kësaj të drejte, veçanërisht nga mediumet.

Qëllimi

Thelbi i trajtimit të kësaj teme, e cila do të elaborohet në shërbim të argumentimit të tezës së ngritur në paragrafin e dytë të pjesës hyrëse të këtij punimi, lidhet me pasqyrimin real të zbatimit në praktikë të të drejtës për qasje në dokumente publike nga institucionet publike. Duke shpalosur rastet specifike të ushtrimit të kësaj të drejte nga përfaqësues mediumesh në vendin tonë, dhe duke marrë për bazë analizimin e rasteve specifike të viteve të fundit. Arsye e përqendrimit tim në rastet studimore të viteve të fundit lidhet me kalimin e mandatit mbikëqyrës të kësaj fushe tek Agjencia për Informim dhe Privatësi në vitin 2019, në saje të të cilit, asaj i është dhënë mekanizmi detyrues i shqiptimit të gjobave ndaj institucioneve publike që nuk përfillim zbatimin e kësaj të drejte nga qytetarët.

Objektivat

Një nga synimet kryesore të hartimit të këtij punimi të karakterit akademik është nxjerrja në pah e një pasqyre reale të ndërgjegjësimit që shteti ka arritur ta krijojë brenda institucioneve publike, përgjegjëse për jetësimin e të drejtës për qasje në raport me qytetarët. Natyrisht, trangu i këtij shkrimi do të trajtojë edhe objektiva tjerë derivativë, të cilët ndërlidhen me faktorët që kanë ndikuar në mungesën e qasjes jokonstruktive, sidomos gjatë dhjetëvjetëshit të parë të zbatimit të ligjit që favorizon publikimin e dokumenteve publike sipas kërkesës.

Për të rritur besueshmërinë, por edhe aspektin funksional rekomandues që bartë mbi vete ky shkrim akademik, në sajë të objektivave të vet, do të trajtohen edhe mekanizmat e ligjshëm dhe alternativë që do të shtyjnë apo mbase edhe detyrojnë përmirësimin e nivelit ekzistues të zbatimit praktik të kësaj të drejte nga vet institucionet publike.

Kryesisht përqendrimi do të jetë në arritjen e këtyre objektivave:

1. Të identifikojë zbatueshmërinë në praktikë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.
2. Të njihemi më nga afër me punën e gazetarëve që ata e bëjnë gjatë procesit të realizimit.
3. Te analizojmë transparencën e institucioneve të Republikës së Kosovës, po ashtu ndikimin e mediave që institucionët të jenë më funksionalë në realizimin e kësaj të drejte.
4. Të shpalosë rolin dhe rëndësinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, si autoritet i apelimit, në mbikëqyrje të këtij ligji dhe në jetësimin e lirisë së informimit nga ana e komunitetit të gazetarëve.
5. Të sintetizojë nivelin e transparencës së institucioneve publike, në bazë të raportimeve vjetore pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, duke sjellë një pasqyrë reale të rasteve të refuzuara apo të heshtura nga institucionet publike.
6. Të ofrojë rekomandime për Agjencinë për Informim dhe Privatësi, si dhe të ofrojë një pasqyrë të thjeshtësuar të procedurave të kërkesave për qasje në dokumente publike për përfaqësuesit e medimeve.

Pyetjet Kërkimore

Me qëllim të respektimit të kriterëve për strukturimin e shkrimit akademik të këtij niveli, përmbajtja e punimit do t'i përgjigjet pyetjeve kërkimore që lidhen me çështjet kryesore të këtij studimi. Do të ofrohen përgjigje në pyetjet:

1. Sa realizohet e drejta e qasjes në dokumente publike në Kosovë.
2. Veç kësaj do të identifikohen parashtruesit më të mëdhenj të kërkesave për qasje në dokumente publike pranë institucioneve publike, pra nëse janë pikërisht mediumet.
3. Përmes intervistimeve do të identifikohen se cilat janë vështirësitë me të cilat përballen gazetarët gjatë realizimit të kësaj të drejte, si parakusht i hartimit të një shkrimi gazetaresk, qoftë i karakterit hulumtues apo jo.
4. Do të zbulohet se në çfarë niveli është transparenca e institucioneve publike.
5. Vëmendje e duhur do ti kushtohet asaj se cila është dinamika e shqyrtimit të ankesave nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, në rastet kur kjo e drejtë nuk realizohet dot në instancën e parë nga pala kërkuese.
6. Do të ofrohen përgjigje ndaj pyetjes se deri në ç'masë arrijnë gazetarët të jetësojnë të drejtën e tyre për t'u informuar në shkallë të dytë (pas shqyrtimit të ankesës nga AIP

Hipotezat

Meqenëse hipotezat që do të paraqes, në thelb, përfaqësojnë përgjigjet e mundshme ndaj pyetjeve kërkimore të shpalosura më sipër, më poshtë po nxjerr në pah gjashtë hipoteza.

1. E para prej të cilave, në fakt, mbështetë tezën kryesore të këtij punimi, duke kristalizuar pohimin se e drejta për qasje në dokumente publike në Republikën e Kosovës realizohet relativisht kënaqshëm, pavarësisht se vazhdon të ketë ende hapësirë për përmirësimin efektiv të gjendjes aktuale.

2. Parashtruesit më të mëdhenj të kërkesave për qasje në dokumente publike në vendin tonë, janë gazetarët dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të përfaqësuar nga të angazhuarit nëpër organizata joqeveritare.
3. Vëzhtrësitë me të cilat përballen gazetarët më së shpeshti gjatë realizimit të kësaj të drejte, lidhen kryesisht me afatet kohore, shpesh të tejkëqitura të marrjes së dokumentit të kërkuar publik.
4. Niveli i transparencës së institucioneve publike lë mjaft për të dëshiruar, pavarësisht përmirësimeve të dukshme të viteve të fundit, që nënkupton një mision të përhershëm të Agjencisë për Informim dhe Privatësi në rolin e saj mbikëqyrës ndaj institucioneve publike.
5. Dinamika e shqyrtimit të ankesave të adresuara nga qytetarët (gazetarët) në Agjencinë për Informim dhe Privatësi është mjaft efektive, megjithë rrjedhave me të cilat ajo po përballlet në funksionalizimin e saj të plotë nga mungesa e mbështetjes nga Kuvendi.

Rëndësia e Temës

Shtjellimi i kësaj teme mund të konsiderohet i një rëndësie të veçantë, meqë kemi të bëjmë me një fushë relativisht të re, të cilës, në dhjetëvjetëshin e parë të promovimit, zbatimit të saj, i ka munguar një autoritet mbikëqyrës që do t'i detyronte institucionet publike ta jetësonin të drejtën e qytetarëve për t'u qasur në dokumente publike. Shpалosja e mekanizmave konkretë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për të detyruar institucionet publike të ofrojnë qasje në dokumente publike, përmes shqiptimit të gjobave, jo vetëm që sjell risi në literaturën e kësaj fushe, por edhe inkurajon qytetarët, në përgjithësi dhe gazetarët, në veçanti, që të shfrytëzojnë intensivisht instancën e dytë të apelimit për të marrë qasje, në rastet kur institucionet publike heshtin ndaj kërkesave të tyre.

Rekomandimet në kuadër të përfundimit të këtij shkrimi akademik, do të mund të ndikonin në përmirësimin e performancës së vet autoritetit të pavarur, si garantues i lirisë së informimit.

Veç tjerash, zbërthimi i hollësishëm i procedurave të thjeshtëzuara për të paraqitur një kërkesë në instancë të parë (cilindo institucion publik) dhe mundësia e realizimit të asaj kërkesë në instancë

të dytë, do të inkurajonte shtimin e numrit të kërkesave ndaj institucioneve publike, e po ashtu edhe paraqitjen e ankesave pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Përmes këtij punimi do të ofrojë për publikun e gjerë informata të hollësishme mbi historikun e zbatimit të kësaj të drejte në Republikën e Kosovës. Punimi, në përgjithësi, mund të shërbejë si një udhëzues edhe për rrjetin e zyrtarëve për qasje në dokumente publike të akredituar nëpër të gjitha institucionet publike. Për më tepër, trangu i këtij punimi do të identifikojë problemet, sfidat me të cilat ballafaqohen gazetarët përgjatë punës së tyre të përditëshme. Do të sjell risi në kuptimin e informatave të dobishme për komunitetin e gazetarëve se cilat kategori të dokumenteve publike duhet të jetë e hapur për ta dhe publikun e gjerë me qasje proaktive të institucioneve, si dhe cilat kategori të dokumenteve janë të mbrojtura me ligj nga publikimi për të ruajtur interesin e shtetit, privatësisë së individit e kështu me radhë.

Metodologjia

Hulumtimi i gjithmbarshëm, për jetësimin e të cilit janë përdorur mënyra të ndryshme të aplikueshme për hulumtime empirike me grupe fokusi, ngërthen në vete një ndërthurje metodologjish të përshtatshme për të spikatur maksimalisht nivelin e jetësimit të të drejtës së komunitetit të gazetarisë për t'u qasur në dokumente publike sipas kërkesës. Për pasqyrimin e kornizës teorike të këtij punimi, në masë të madhe është aplikuar metoda deduktive, duke e pranuar si të vërtetë përcëtimin e përgjithshëm konkludues mbi ekzistimin e barrierave të krijuara nga institucionet publike ndaj gazetarëve për t'u qasur në dokumentet publike të kërkuara.

Ky përcëtim, mëpastaj do të argumentohet përmes burimeve të drejtpërdrejta, respektivisht nga hulumtimi i zhvilluar në raport me përfaqësues të gazetarisë, të cilët kanë pasur përvojë, jo rrallë të hidhur, me institucionet publike që nuk janë treguar mjaftueshëm bashkëpunese me ta, në cilësinë e paraqitësve të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Elementët më të rëndësishëm të metodës deduktive, si procedurat e metodave të analizës, sintezës, përgjithësimit dhe specializimit janë aplikuar për të arritur të mbrohet teza e ngritur në hyrjen e këtij studimi.

Metoda krahasuese e përcjell në vazhdimësi ndërtimin e punimit, e cila shërben edhe si njësi matëse për vlerësimin e transparencës së shfaqur të institucioneve publike në raport me gazetarët. Nxjerrja e të dhënave mbështetëse, shumë prej tyre të papublikuara më parë, përmes

metodës së observimit, e pasuron këtë punim me informata burimore primare që sjell thelbin e sfidave të përditshme të gazetarisë në vendin tonë, të paraqitura në faqet e hulumtimit tim përmes intervistave të zhvilluara.

Vlerësimet e mia individuale, të bazuara në përvojën personale në fushën e lirisë së informimit, të mbështetura në burime të besueshme zyrtare, paraqesin një këndvështrim real të nivelit të përkushtimit të institucioneve publike për fuqizimin e lirisë së informimit.

BIBLIOGRAFIA

- Abrashi, G., & Sallauka, U. (2022). Use of Information Technology in Academic Library Practice. *The International Information & Library Review*, 54(4), 380–386.
<https://doi.org/10.1080/10572317.2022.2124834>
- Anders Chydenius Foundation, *The World's First Freedom of Information Act*,. Anders Chydenius' Legacy Today, Publications 2, p.4, 2006;
- Agim A. Krasniqi, DEMOKRACIA DHE TRANZICIONI, Etika në Funksion të Shërbimeve Publike dhe të Anitkorrupsionit, Prishtinë, 2017;
- David Held, Modelet e Demokracisë (edicioni i tretë) Cuneus, Prishtinë 2011;
- Flutra Kusari, *E Drejta e Qasjes në Informacione Publike, Jurispodenca vendore dhe Ndërkombëtare*, dhjetor 2018;
- Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, *Ligji Nr. 2003 / 12*, Prishtinë, Nr. 17, i fuqizuar më 01 tetor 2007;
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 03/L-215*, Prishtinë, 25 nëntor 2010;
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 06/L-081*, Prishtinë, 04 korrik 2019;
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Ligji Nr. 03\L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Sigurisë, Prishtinë 2010;
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji Nr.06/2010 për Qasjen e Lirë në Informacione Publike;
- Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive, *Doracak për Qasje në Dokumente Publike*, USAID, 2013;
- Information Commissioner's Office, 'Access to Information Held in Complaint Files', Mbretëria e Bashkuar, 2011;
- Information Commissioner's Office, 'Hoë to Disclose Information Safely', *Removing Personal Data from Information Requests and Datasets*, Mbretëria e Bashkuar, 2015;
- Information Commissioner's Office, 'Taking a Positive Approach to Information Rights', Mbretëria e Bashkuar, 2012;

- Saliu, H. (2022). Rethinking Media Diplomacy and Public Diplomacy Towards a New Concept: Digital Media Diplomacy. *Online Journal Modelling the New Europe*, 39, 1-24. DOI: [10.24193/OJMNE.2022.39.01](https://doi.org/10.24193/OJMNE.2022.39.01)
- Saliu, H., Rexhepi, Z., Shatri, S. & Kamberi, M. (2022). Experiences with and risks of internet use among children in Kosovo. *Journal of Elementary Education*, 15(2), 145–164. <https://doi.org/10.18690/rei.15.2.145-164.2022>
- Saliu, H., Bicaj, A. (2022). The Digital Competence of Future Teachers in Kosovo. In L. Tomczyk & L. Fedeli, (eds), *Digital Literacy for Teachers. Lecture Notes in Educational Technology*. Springer, Singapore. (275-290). https://doi.org/10.1007/978-981-19-1738-7_15
- Saliu, H. (2022). Public Diplomacy or Public Glocalization? Rethinking Public Diplomacy in the post-Truth Era. *Vestnik Moskovskogo universiteta. Seriya 10. Zhurnalistika*, 1, 157-175. DOI: [10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175](https://doi.org/10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175)
- Saliu H. & Lljunji V. (2022). Cultural Diplomacy of Kosovo after the Declaration of Independence. *Information & Media*, 93, 62-76. <https://doi.org/10.15388/Im.2022.93.61>
- Saliu, H. (2021). The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave*, XXXVII(96–97), 189–207. <https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf>
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- McDonagh, Maeve, *The Right to Information in International Human Rights*, Oxford University Press, 2013;
- Ministria e Administratës Publike, Republika e Kosovës, ‘Karta për Hapjen e të Dhënave në Republikën e Kosovës’, Plani i Veprimt, 2017;
- Privacy Rights Clearing House, *Social Netöorking Privacy: Hoë to be Safe, Secure and Social*, 2016;
- Služben Vesnik na Republika Severna Makedonija, Zakon Nr.08-2878/1 za Sloboden Pristap do Informacii od Javen Karakter, 22 maj 2019;
- Raportet Gjithpërfshirëse për Realizimin e Qasjes në Dokumente Publike të Zyrës së Kryeministrit për vitet 2011 – 2018;
- Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filologjik-Dega e Gazetarisë, “MEDIA, Revistë Kërkimore 4”, Prishtinë, 2012;

USAID, 'Doracak për Qasje në Dokumente Publike', Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive, 2013;

Ibrahim Berisha, Media- Agjenset e komunikimeve, Universiteti AAB, Prishtinë, 2009.

BURIME NGA INTERNETI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Republika e Shqipërisë, faqja zyrtare. Shikuar më 09.06.2021. <https://ëëë.pyetshtetin.al/kompetencat-e-komisionerit-per-te-drejtjen-e-informimit-dhe-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale/>;

Institucioni i Avokatit të Popullit, Marrë nga faqja Zyrtare e IAP më 06.09.2021. <https://oik-rks.org/per-ne/>;

Poverenik za Informacije od Javnog Značaja i Zaštitu Podataka o Ličnosti Republike Srbije. <https://ëëë.poverenik.rs/sr-yu/>;

Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka i Slobodan Pristup Informacijama Crne Gore. [http://ëëë.azlp.me/me/agencija](http://ëëë.azlp.me/me/agencija;);

Službeni List Crne Gore br.44, Zakon o Slobodnom Pristupu Informacijama, 09 avgust 2012;

Zakon o Slobodnom Pristupu Informacijama od Javnog Značaja, Sl. glasnik RS, br. 120/2004, 54/2007, 104/2009 i 36/2010;

Agencija za Zaštita na Ličnite Podatoci na Republika Makedonija. <https://dzlp.mk/en/node/2181>;

Jeton Arifi (27.06.2018), Drejtor, Agjencia për Informim dhe Privatësi. Marrë nga editoriali me titull 'Hapërimi i Kujdestarit të Privatësisë', botuar në Portalin '2Lonline', Kosovë. Marrë më 09.06.2021 nga: <https://2lonline.com/haperimi-i-kujdestarit-te-privatesise/>;

Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor për 2019*, f.45. Marrë më 10.06.2021 në: <https://oik-rks.org/2020/04/02/raporti-vjetor-2019/>;

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Faqja Zyrtare, *Rreth Nesh*. Marrë më datë: 06.06.2021 nga: <https://ëëë.idp.al/rreth-nesh/>;

Faqja Zyrtare e UNESCO-së, Dita Ndërkombëtare për Qasje Universale në Informacione, <https://en.unesco.org/commemorations/accesstoinformationday>, 06.10.2021;

Raportet Gjithpërfshirëse për Qasje në Dokumente Publike. Marrë më 21 shkurt 2020.
<https://kryeministri-ks.net/dokumente/?kategoria=raportet-gjitheperfshirese-per-realizimin-e-te-drejtes-per-qasje-ne-dokumente-publike&viti=>

Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike,
<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

Web Faqja zyrtare e Zyrës së Krzeministrit të Kosovës, Raportet Gjithpërfshirëse për Qasje në Dokumente Publike.

BURIME NGA MEDIA ONLINE

Qasja në dokumente zyrtare — pengesat dhe e drejta për t'u informuar
<https://opendatakosovo.medium.com/qasja-n%C3%AB-dokumente-zyrtare-pengesat-dhe-e-drejta-p%C3%ABr-tu-informuar-351be108ce4b>; <https://opendatakosovo.org/about/>

Shkeljet Ligjore e Kushtetuese në Privatizimin e KEDS dhe TC 'Kosova e Re
<https://kallxo.com/tag/qasje-ne-dokumente-publike/>

MSH-ja nuk i jep qasje në dokumente, D.Molliqaj publikon letrat
<https://ëëë.gazetaexpress.com/msh-ja-nuk-i-jep-qasje-ne-dokumente-dardan-molliqaj-publikon-letrat/>

(Mos)qasja në dokumente publike në Kosovë
Zëri i Amerikës (VOA) <https://ëëë.facebook.com/ëatch/?v=276337473186190>